



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2024:010193
Datë: 19.03.2024
Numri i dokumentit: 05474283

PPP.nr.466/2023

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, si përbarimore e përberë nga Gjyqtari individual Blerim Istrefi, ne çështjen juridike të kreditorit KUR Mitrovica Sh.A., me adresë rruga “Bislim Bajgora”, Mitrovicë, kundër debitorit I.S nga M, përfaqësuar nga A.Sh av në M, për shkak të borxhit në shumë prej 400.50 €, pas prapësimit të ushtruar nga ana e debitorit, me dt.14.12.2023 kundër urdhrimit mbi lejimin e përbarimit, gjykata jashtë seance me dt.19.03.2024 nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET POSHTË prapësimi i debitorit: I.S nga M, ushtruar kundër urdhrimit mbi lejimin e përbarimit P.nr.406/2023 të dt.24.11.2023 për shkak të borxhit në shumë prej 400.50 €, si i PA AFATSHËM.

A r s y e t i m

Kreditori, KUR Mitrovica Sh.A., me adresë rruga “Bislim Bajgora”, Mitrovicë, ka ushtruar propozimin për përbarim të përbaruesi privat, me të cilin ka kërkuar që të lejohet përbarimi ndaj debitorit: I.S nga M, si në shkresat e lëndës, për borxh në shumë prej 400.50€, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore, të gjitha këto në afat 7 ditor nga pranimi i urdhrimit, në të kundërtën të bëhet bllokimi i llogarive bankare të debitorit, sekuestrimi regjistrimi dhe shitja e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme, e shuma e mjeteve të transferohet në llogari të kreditorit, të gjitha të specifikua në propozimin për përbarim të datës 23.11.2023.

Përbaruesi privat me urdhër P.nr.406/2023 të dt.24.11.2023 e ka lejuar propozimin për përbarim.

Pas lejimit të përbarimit me urdhër përbarimor, të njëjtin përbaruesi privat ja ka dorëzuar debitorit të cilin e ka pranuar I. S nga M me datë 06.12.2023 me paralajmërimin se pala e pakënaqur ka të drejtë të paraqes prapsim në afat 7 ditor nga dita e pranimi të të njëjtit.

Debitori, përmes të autorizuarit ka ushtruar prapsim me dt: 14.12.2023 kundër urdhrimit për përbarim P.nr.406/2023 të dt.24.11.2023, me të cilën është lejuar përbarim sipas propozimit të kreditorit KUR Mitrovica Sh.A.

Nga shkresat e lëndës, konstatohet se debitori, nuk ka vepruar brenda afatit ligjor të përcaktuar për paraqitjen e prapsmit kundër urdhrit mbi lejimin e përmbarimit, andaj gjykata, bazuar në nenin 70 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore i cili thotë citoi “Prapësimi duhet të paraqitet gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbarues ose urdhrit përmbarues” e në rastin konkret debitori I.S nga M e ka pranuar propozimin për përmbarim të lejuar me urdhër me datë 06.12.2023, dhe afati ka filluar të ecë nga data 07.12.2023, ndërsa prapësimin e ka parashtruar me datë 14.12.2023, e nga pranimi i propozimit të përmbarimit e deri me ditën e paraqitjes së prapësimit kanë kaluar 8 ditë, e në rastin konkret afati i fundit për ngritjen e prapësimit ka qenë data 13.12.2023, ashtu që prapësimi i debitorit konsiderohet si I PA AFATSHËM.

Andaj, nga të lartcekurat e duke u bazuar në nenin 70 dhe 73.3 të LPP-së (Ligjit të Procedurës Përmbarimore), u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
PPP.nr.466/2023, dt.19.03.2024

GJYQTARI
Blerim Istrefi

UDHEZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa ushtrohet përmes kësaj gjykate.